



Datë: 23.07.2025
Numër Protokolli: 5048/2025

A.nr.1061/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1061/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesja A.H-B, me përfaqësues të autorizuar avokat Kemajl Ademaj, kundër organit të punësimit: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1061/2025, e datës 04.06.2025, e parashtruar nga ankuesja A.H-B.

II. Mbetet në fuqi, Njoftimi i datës 29.05.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën “Asistent për Laborator”, i Sektorit të Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

A r s y e t i m

Ankuesja A.H-B. (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 04.06.2025 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat Kemajl Ademaj, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr. 1061/2025, lidhur konkursin me numër referencës RN00017076, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm për pozitë, “Asistent për Laborator”, të Zhvilluar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, kundër njoftimit të datës 29.05.2025, me pretendimet ankimore se kam aplikuar në konkurs për pozitën dhe posedojë diplomën e shkollës se mesës ekuivalente më të dhe se organi i punësimit me datës 29.05.2025, ka publikuar njoftimin përmes të cilit njoftim është renditur kandidati H.R, me gjithsejtë 92.2, pikë, ndërsa ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 73, pikë dhe se njoftimin e kundërshtojë për shkak të Shkeljeve të së drejtës Procedurale, Konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të Dispozitave të së drejtës materiale, me tej ankuesja ka pretenduar nga Këshilli që Këshilli të

aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar duke ndryshuar njoftimin e datës 29.05.2025 ashtu që të vërtetohet se ankuesja i ka plotësuar kriteret e përgjithshme për pozitën "Asistent për Laborator", duke u renditur e para në Listë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 17.06.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.Nr. 1061/2025 të datës 04.06.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër referencë RN00017076, të datës 13.03.2025; Njoftimi i datës 29.05.2025, i Sektorit të Personelit të AUV-së; Autorizimin e datës 16.12.2024, nga A,B, për K.A; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesen; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.06.2025, dërguar përmes emailit, nga R.K për V.K; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1061/2025, e datës 17.06.2025; Vendimi me numër protokolli 3235, i datës 25.04.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i AUV-së; Akt Emërimi i datës 10.05.2018, për K.U; Akt Emërimi i datës 07.07.2021, për Xh.M; Akt Emërimi i datës 23.08.2013, për B.J; Vendimi me numër protokolli 02.04.2025, për Q.M; Akt Emërimi i datës 01.01.2014, për Q.M; Akt Emërimi i datës 09.06.2021, për V.K; Njoftimi i datës 24.04.2025; Pyetjet e hapura për testim me shkrim; Aplikacioni i A.B, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 741, e datës 05.09.2018, për A.H e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomë e datës 09.09.2022, për A.H e lëshuar nga Universiteti i Tetovës; Vendimi me numer ref; nr.126-4880, i datës 23.12.2022, i lëshuar nga Kryesuesja e Këshillit Shtetëror për Njohje e Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacioni; Vërtetim i datës 11.11.2024, për A.H; Aplikacioni i H.R, me shkresat e bashkangjitura; diplomë e shkollës së mesme për H.R; me numër protokolli 06-1894/10, e datës 25.08.2020; Pasqyra e Trustit për H.R, për periudhën nga data 24.02.2009, deri me datën 18.03.2025; Letër rekomandim i datës 04.02.2021; Kopje e letërnjoftimit për H.R; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 26.05.2025, sipas kodit CN7311; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 26.05.2025, sipas kodit CN7993; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.S, nga anëtari i komisionit Xh.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.S, nga anëtari i komisionit B.J; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.S, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.S, nga anëtari i komisionit V.K; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin A.H.B, nga anëtari i komisionit K.U; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin A.H.B, nga anëtari i komisionit Xh.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin A.H.B, nga anëtari i

komisionit B.J; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin A.H.B, nga anëtari i komisionit Q.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin A.H.B, nga anëtari i komisionit V.K; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.M, nga anëtari i komisionit K.U; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.M, nga anëtari i komisionit Xh.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.M, nga anëtari i komisionit B.J; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin R.M, nga anëtari i komisionit V.K; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtari i komisionit K.U; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 28.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtari i komisionit Xh.M; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 28.05.2025; Njoftimi i datës 29.05.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën “Asistent për Laborator”, i Sektorit të Personelit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datë 13.03.2025 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00017076, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën ” Asistent për Laborator”, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 3 me afat aplikimi nga data 14.03.2025 deri me datë 12.04.2025.

Tutje, Sektori i Personelit i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 12.05.2025, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati H.R është vlerësuar me gjithsejtë 92.2, pikë ndërsa ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 73, pikë.

Ankuesja A.H-B, e pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 04.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se kam aplikuar në konkurs për pozitën dhe posedojë diplomën e shkollës se mesës ekuivalentë më të dhe se organi i punësimit me datës 29.05.2025, ka publikuar njoftimin përmes të cilit njoftim është renditur kandidati H.R, me gjithsejtë 92.2, pikë, ndërsa ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 73, pikë dhe se njoftimin e kundërshtojë për shkak të Shkeljeve të së drejtës Procedurale, Konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të Dispozitave të së drejtës materiale, me tej ankuesja ka pretenduar nga Këshilli që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar duke ndryshuar njoftimin e datës 29.05.2025 ashtu që të vërtetohet se ankuesja i ka plotësuar kriteret e përgjithshme për pozitën ”Asistent për Laborator”, duke u renditur e para në Listë.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka

analizuar konkursin me numër të referencës RN00017076, për , për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën ” Asistent për Laborator’’, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 3, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

Arsimi i kërkuar: *Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të.*

Përvoja e punës; *nuk kërkohet.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën , për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën ” Asistent për Laborator’’, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 3, kanë qenë në pajtim me kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës. Po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjet e kandidatja fituese H.R dhe ka konstatuar së e njëjti i kanë plotësuar kriteret lidhur me arsimimin e kërkuar ashtu siç ka qenë e përcaktuar me konkurs për pozitën e lartcekura

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të kësaj çështje ka gjetur së Komisioni i Pranimit, i themeluar sipas vendimit me numër protokolli 3235, të datës 25.04.2025, të nxjerr nga, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përgjegjës për vlerësimin profesional të kandidatëve në këtë procedurë të rekrutimit, ka qenë komisioni në këtë përbërje: z. Kujtim Uka, Kryesues i Komisionit, i cili sipas Akt emërimit me numër protokolli 3575 të datës 10.05.2018, mbanë pozitën e punës ‘’ Drejtor i Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë, z. X.M, i cili sipas Akt emërimit me numër protokolli 4730 të datës 07.07.2021, mbanë pozitën e punës’’ Udhëheqës i Sektorit të Pato Histologjisë’’, z. Besart Jashari, i cili sipas Akt emërimit me numër protokolli 3532 të datës 28.03.2013, mbanë pozitën e punës’’ Udhëheqës i Sektorit të Mikrobiologjisë së Ushqimit dhe Preparotisë’’, z.Q.M, i cili sipas Akt emërimit me numër protokolli 1516 të datës 01.04.2014, mbanë pozitën e punës’’ Inspektor Veterinar’’, ndërsa sipas vendimit me numër protokolli 2610, të datës 02.04.2025, të nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv, i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, transferim në pozitën ‘’ Zyrtar për Veterinari’’, dhe znj.V.K, i cila sipas Akt emërimit me numër protokolli 4253 të datës 09.06.2021, mbanë pozitën e punës’’ Zyrtare e Personelit’’. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se komisioni i pranimit, ka qenë në përputhje me nenin 40, paragrafi 1,2, nen paragrafi 2.1,2.2,2.3 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku thuhet se: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale, si dhe nenit 20, paragrafi 1, 2, nen paragrafi 2.1,1.2 dhe 2.3 të Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se;1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale themelohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon procedurën e rekrutimit për institucionet e administratës

shtetërore. Komisioni i pranimit në institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2.Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje:2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi;2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse.

Thënë me tepër, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore iu referua nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin është përcaktuar se: *Procedura e pranimit në Shërbimin Civil 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.2.Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.*

Referuar kuadrit ligjor si me lart Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidatit H.R, të shpallur fitues dhe si rrjedhojë ka gjetur se i njëjti posedon Diplomë me numër protokolli 06-1794/10, të datës 25.08.2020, të lëshuar nga SMLP “ Ismajl Dumoshi”, në Obiliq, me çka dëshmohet se ka përfunduar shkollimin e mesëm dhe të lartë drejtimi Elektro profili Energjetikë.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon së Njoftimi i datë 29.05.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare pa numër dhe se ankueses i është dorëzuar në emali. Kolegji i Këshillit së ky pretendim ankimore është në kundërshtim me nenin 11, paragrafi 1,2,3, të të Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se;1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të

vlerësimit.2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimi përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.3.Lista publikohet në SIMBNj, në uebfaqen e institucionit dhe mjete të tjera të përshtatshme për informim, sepse nga shkresat e lendes konstaton se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, e ka publikuar në SIMBNj, ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi dhe se pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton Sektori i Personelit i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me rastin e shpalljes së Njoftimit të datës 12.05.2025 për Renditjen përfundimtare të kandidatit për pozitën e punës ‘‘ Asistent për Laborator, sipas konkursit me numër reference RN00017076, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 1061/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses avokatit Kemajl Ademaj;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së